



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

Nr. 846/P Prot.

Tiranë, më 21. 3 .2024

**URDHËR**

Nr. 02 , Datë 21 . 03 .2024

**“Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”**

Bazuar në nenin 36, pika 7 dhe nenin 39 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në nenin 5, pika 3, e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës" dhe Urdhrin nr. 101, datë 13. 03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institutet Publike të Arsimit të Lartë", të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e autoritetit më të lartë drejtues në Universitetin e Tiranës,

**URDHËROJ:**

1. Dita e fillimit të procesit zgjedhor për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës, është data 21 Maj 2024.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës, është data 21 Qershor 2024.
3. Ky Urdhër i përcillet për njohje dhe zbatim, të gjitha njësive kryesore dhe njësive të tjera në përbërje të Universitetit të Tiranës.
4. Ky Urdhër të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës dhe në faqen zyrtare të çdo njësie kryesore dhe çdo njësie tjetër, në përbërje të Universitetit të Tiranës.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

